



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1190 prot.

Tiranë, më 11.08.2021

### V E N D I M

**Nr. 150, datë 11.08.2021**

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 27, datë 23.02.2021, të I. G., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*”<sup>1</sup>, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë (në vijim DRAP Lezhë) dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Shkodër (në vijim ZVAP Shkodër).

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, shtetasi I. G. në ankesën e sjellë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), sqaron se ka përfunduar studimet universitare në profilin Edukim Fizik. Më datë 17.08.2020, ka konkuruar në Portalin “*Mësues për Shqipërinë*” dhe është renditur në vendin e parë, në profilin Edukim Fizik.

Sipas tij, në shkollat e qytetit të Shkodrës ka vende vakante për mësues të Edukimit Fizik, por nga ana e DRAP Lezhë dhe ZVA Shkodër, nuk bëhet shpallja e këtyre vendeve, duke bërë që ai të mos emërohet në njërin prej tyre.

Përsa më sipër, ankuesi pretendon se me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të sipërcituara, DRAP Lezhë dhe ZVAP Shkodër, kanë bërë që ai të diskriminohet për shkak të bindjeve politike.

<sup>1</sup> Referuar Vërtetimit të lëshuar nga ana e subjektit politik “Partia Demokratike”, Dega Shkodër, datë 18.02.2021, ankuesi është anëtarë i këtij subjekti prej vitit 2015.

Në këtë kuptim, ankuesi kërkon nga Komisioneri, të konstatojë situatën diskriminuese dhe emërimin e tij në një prej pozicioneve vakante të profilit Edukim Fizik.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së<sup>2</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Pas analizimit paraprak të ankesës së I. G. u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/4 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 365/1 prot., datë 04.03.2021 nga ana e KMD i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues<sup>3</sup> DRAP Lezhë dhe ZVAP Shkodër, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

---

<sup>2</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

<sup>3</sup> Është kërkuar konkretisht:

- Argumentimin, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

Në përgjigje përsa më sipër, DRAP Lezhë, me anë të shkresës<sup>4</sup> nr. 365/1 prot., datë 12.04.2021, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “...I. G. është kandidat i portalit ‘Mësues për Shqipërinë’, viti 2020, profili edukim fizik i renditur në vend të parë të klasifikimit. I. G. ka kërkuar punësimin e tij si mësues i edukimit fizik në institucionet arsimore në juridiksion të ZVAP Shkodër. Procedurat e punësimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar kryhen bazuar në dispozitat e Udhëzimit të MASR nr. 13, datë 22.05.2019 ‘Për procedurat e emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar’ dhe për administrimin e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’ dhe Udhëzimit nr. 30, datë 12.09.2018 ‘Për numrin e nxënësve për klasë dhe format e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar. Aktet nënligjore të sipërcituara kanë përcaktuar saktësisht procedurën dhe kompetencat e secilit institucion në emërimin e mësuesve.

Së pari: Lëvizja Paralele e mësuesve brenda sistemit me dëshirë ose për shkak të mungesës së ngarkesës mësimore. Bazuar në Udhëzimin nr. 13, datë 22.05.2019, Kreu 1, pika 7: Vendet e lira të punës shpallen pasi është bërë plotësimi i kërkesave për lëvizje paralele dhe sistemimi i mësuesve që mbeten pa ngarkesë mësimore në zyrat vendore të arsimit parauniversitar jo më vonë se 1 (një) muaj para fillimit të vitit mësimor.

Për vitin shkollor 2020-2021, Lëvizja Paralele në ZVAP Shkodër është zhvilluar me datë 11.08.2020. Një kandidat i profilit edukim fizik ka kryer lëvizje paralele me dëshirë, nga Shkolla 9 vjeçare ‘Branko Kadia’ në Gjimnazin ‘Oso Kuka’. Shkolla 9-vjeçare ‘Branko Kadia’, me shkresën nr. 311 prot. datë 12.08.2020 ‘Informacion për numrin e orëve për mësuesit e edukimit fizik dhe argumentet për mos shpallje të vendit vakant’, drejtuar ZVAP Shkodër, ka dërguar orët e lira të edukimit fizik pranë kësaj zyre dhe ka paraqitur argumentat për mosshpalljen e këtyre orëve pas lëvizjes paralele.

Së dyti: Punësimi i mësuesve të Portalit ‘Mësues për Shqipërinë’. Procedura e punësimit të kandidatëve të Portalit ‘Mësues për Shqipërinë’, është...:

- ZVAP për një vend të lirë pune, njofton kandidatët përmes postës elektronike, të cilën kandidati e ka deklaruar gjatë aplikimit online dhe me dosje.
- Kandidati, i cili në renditjen e përgjithshme është renditur me numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën e zgjedhjes për vendin e lirë të punës dhe është i deyruar të konfirmojë në ZVAP brenda 24 orëve nëpërmjet adresës elektronike. Në rast të moskonfirmimit nga kandidati, ky pozicion pune i ofrohet kandidatit të listuar në rend më poshtë. Midis kandidatëve që rezultojnë me pikë të barabarta, përparësi ka kandidati që mund të jetë në kategorinë e personave me aftësi të kufizuara. Në rast se nuk ka persona

- 
- Informacion dhe kopje të shkresave, nëse subjektit ankues i është kthyer përgjigje sa i përket pretendimeve të tij.
  - Informacion dhe kopje të procedurës së emërimit, nëse gjatë periudhës Gusht 2020 e në vijim, është punësuar ndonjë mësues në profilin Edukim Fizik, në shkollat e qytetit të Shkodrës.
  - Informacion nëse në shkollat e qytetit të Shkodrës ka pozicione të lira pune, si mësues të Edukimit Fizik.

<sup>4</sup> Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 365/3 prot., datë 16.04.2021

me aftësi të kufizuara, vendi i lirë i punës i ofrohet kandidatit që ka rezultatin më të lartë në testim.

- Kandidati fitues paraqitet në institucionin arsimor ku ofrohet vendi i lirë i punës menjëherë sapo merr njoftimin. Ai i dorëzon drejtorit të institucionit dokumentin vërtetues, të printuar nga sistemi i aplikimit online, në portalin 'Mësues për Shqipërinë'.
- Kandidati punësohet nga drejtori i institucionit arsimor me kontratë pune individuale, me ose pa afat, sipas kërkesave të vendit të lirë të punës.

I. G. ka drejtuar ankesë në DRAP Lezhë dhe në Platformën e Bashkëqeverisjes për mos punësimin në institucionet arsimore në juridiksion të ZVAP Shkodër. Pretendimet e ankuesit kane qenë se drejtoritë e institucioneve arsimore nuk shpallin vëndet vakante të profilit. DRAP Lezhë ka kërkuar informacion nga ZVAP Shkodër mbi të gjitha ngarkesat mësimore të institucioneve arsimore të kësaj zyre. Bazuar shkresës së ZVAP Shkodër, nr. 2185 prot., datë 16.11.2020, 'Mbi ngarkesën mësimore në lëndën edukim fizik për shkollat 9-vjeçare dhe të mesme', institucionet arsimore të kësaj zyre nuk kanë paraqitur orë të lira të profilit edukim fizik. Me Urdhër nr. 103, të drejtorit të DRAP Lezhë, me datë 16.11.2020, është ngritur grupi i inspektimit për verifikimin e ngarkesës mësimore në Shkollën 9-vjeçare 'Branko Kadia' për mos shpalljen e vendit vakant për shkak të lëvizjes paralele të mësueses F. B. profili edukim fizik në Gjimnazin 'Oso Kuka'. Pas inspektimit, DRAP Lezhë ka dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar relacionin nr. 2177/1 prot., datë 27.11.2020, me konkluzionet si më poshtë:

1. Shkolla 'Branko Kadia' bazuar në Udhëzimin nr. 13, datë 22.05.2019 'Për procedurat e emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit 'Mësues për Shqipërinë', të dërgojë në ZVAP Shkodër, Njoftimin për shpalljen e 16 orëve të lira të lëndës edukim fizik.
2. Shkolla 9-vjeçare 'Branko Kadia', të rishikojë shpërndarjen e ngarkesës mësimore të mësuesve sipas Udhëzimit nr. 30, datë 12.09.2018 'Për numrin e nxënësve për klasë dhe format e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar'.

Ndërsa Shkolla 9-vjeçare 'Branko Kadia' ka dërguar në DRAP Lezhë shkresën nr.226 prot. datë 22.01.2021 "Kthim përgjigje relacioni". Sipas shkresis Shkolla 9-vjeçare "Branko Kadia" për vitin shkollor 2020-2021 në kushtet pandemisë nuk ka orë në lëndën e edukimit fizik. Kjo është arsyeja pse nuk ka patur emërim të ri në profilin edukim fizik.

Shkolla 9-vjeçare 'Branko Kadia' është institucioni përgjegjës i cili menaxhon ngarkesën mësimore të shkollës dhe shpalljen e vendeve të lira të punës me ose pa afat.

DRAP Lezhë ka zhvilluar inspektim në Shkollat 9-vjeçare 'Salo Halili', 9 vjeçare 'Ndre Mjeda', 9 vjeçare 'Azem Hajdari', për të verifikuar ngarkesat e mësuesve të edukimit fizik në shkollë dhe orë të lira të këtij profili. Me relacionin nr. 2282 prot. datë 09.12.2020, DRAP Lezhë ka dërguar në DPAP dhe ZVAP Shkodër gjetjet e grupit të inspektimit, konkretisht:

1. Institucioni arsimor 'Salo Halili', ka 18 klasa gjithsej, ku 10 klasa janë në AF dhe 8 klasa janë në AMU. U kostatua se dy mësuesit definitiv të profilit edukim fizik kanë përkatësisht 24 dhe 25 orë mësimore në javë secili ose +2 dhe + 3 orë mbi normën e tyre. Ndërsa 9

*orë të tjera të profilit edukim fizik janë shpërndarë mësuesve në shkollë për të plotësuar ngarkesën mësimore, megjithëse nuk janë profil i përafërt siç citohet në Udhëzimin Nr.30 dt. 12.08.2018, Kreu V- 'Të përgjithshme', pika 1.*

- 2. Institucioni arsimor 'Ndre Mjeda', ka 36 klasa gjithsej, ku 20 klasa janë në AF dhe 16 klasa janë në AMU. U konstatua se 5 mësuesit definitiv të profilit edukim fizik kanë përkatësisht 22, 21, 24, 22, 22 orë mësimore. Ndërkohë u konstata se numri i nxënësve në paralelet e klasave të; I është 87 nxënës, kl.II është 97 nxënës, kl.III është 92 nxënës, kl. IV është 89 nxënës , kl.VI është 97 nxënës dhe kl. IX është 94 nxënës. të ndarë në 4 klasa gjë e cila është në kundërshtim me Udhëzimin Nr.30 dt.12.08.2018 Kreu II/A pika 2/b. Sipas drejtoreshës së shkollës kjo situatë është vetëm për këtë vit shkollor si pasojë e pandemisë, pasi klasat nuk kanë hapësira të mjaftueshme për të ruajtur distancën midis nxënësve nga njëri- tjetri. Theksojmë sipas drejtoreshës së shkollës kjo gjë është bërë me aprovimin e drejtorit të DRAP Lezhë vetëm për këtë vit shkollor në kushtet e pandemisë. Si rezultat me 3 orët e profilit edukim fizik të shtuara në këtë situatë plotëson normën mësimore mësuesi i profilit TIK megjithëse nuk janë profil i përafërt siç citohet në Udhëzimin Nr. 30, dt.12.08.2018 Kreu V- "Të përgjithshme", pika 1.*
- 3. Institucioni arsimor 'Azem Hajdari', ka 16 klasa gjithsej, ku 8 klasa janë në AF dhe 8 klasa janë në AMU. U konstatua se 2 mësuesit definitiv të profilit edukim fizik kanë përkatësisht nga 22 orë secili.*
- 4. Sipas shkresës së Shkollës 9-vjeçare 'Salo Halili', nr. 510, prot. datë 21.01.2021, ky institucion nuk ka shpallur orët e lira sipas rekomandimit të DRAP Lezhë.*

*Për sa mësipër, DRAP Lezhë ka sqaruar procedurat e punësimit të mësuesve dhe kompetencat funksionale të secilit institucion.*

*Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, sqaron se pretendimi i I. G. për mos punësimin e tij në institucionet arsimore të ZVAP Shkodër për shkak të diskriminimit për bindje politike është i pabazuar dhe në asnjë moment i justifikueshëm.*

*DRAP Lezhë ka sqaruar bazën ligjore dhe kriteret e emërimeve të mësuesve në sistemin arsimor krejtësisht të ndryshëm nga objekti i ankesës drejtuar institucionit tuaj.*

*Si konkluzion, ZVAP Shkodër ka shpallur një vend të lirë punë me afat, profil edukim fizik në muajin shkurt 2021, në Shkollën 9-vjeçare 'Qazim Mehja'. Ky vend pune është pranuar nga kandidati I. G....".*

Në përgjigje për sa më sipër, ZVAP Shkodër, me anë të shkresës<sup>5</sup> nr. 509/1 prot., datë 12.03.2021, informoi Komisionerin ndër të tjera se: "...

- 1. Drejtoria e IA 'Kolë Margjini' (shkolla Pyjore) me email të datës 17.11.2020 njofton që kandidatët I. G. dhe Arens Shabaj kanë refuzuar kërkesën për mësues të kësaj shkolle. (Bashkëngjitur korrespondenca mes ZVAP Shkodër dhe IA 'Kolë Margjini' (shkolla Pyjore) përmes e-maileve.*

---

<sup>5</sup> Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 328/2 prot., datë 22.04.2021

2. ZVAP Shkodër me datë 09.12.2020 ka bërë shpalljen për vend pune në shkollën 9-Shtatori, Nj. Administrative Topojan, shpallje dërguar nga DRAP Lezhë. I. G. shkruan: 'Ça asht ky email me u tall? Unë n'vend t'parë në shkodër m'ofroni vend punet në Kukës? ... Bashkëngjitur email datës 09.11.2020.
3. ZVAP Shkodër më datë 15.12.2020 ka bërë shpalljen për vend pune në shkollën "Haxhi Hajdari", Nj. Administrative Rrethina. I. G. nuk ka kthyer përgjigje brenda 24 orëve siç parashikohet në kreun 4, pika 5 të Udhëzimit

*Pra I. G. i janë ofruar vende pune në institucionet arsimore të cilat i ka refuzuar.*

4. Me datë 24.02.2021 drejtori i institucionit arsimor 'Qazim Mehja' ka depozituar në sekretarinë e ZVAP Shkodër kërkesë për personel mësimor për profilin edukim fizik. Komisioni i ZVAP Shkodër ka zhvilluar procedurën e parashikuar në Udhëzimin e MASR-së nr. 13, datë 22.05.2019, për punësimin për këtë profil dhe është emëruar kandidati i renditur i pari I. G. Bashkëngjitur deklarata e pranimit të I. G."

*Me datë 20.01.2021, I. G. ka depozituar në sekretarinë e ZVAP Shkodër një kërkesë me anë të së cilës kërkon të gjithë procedurat dhe dokumentacionin e lëvizjes paralele të profilit Edukim Fizik për vitin 2020-2021. Bazuar në ligjin Nr. 119/2014 'Për të Drejtën e Informimit' dhe në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 'Për Mbrojtjen e te Dhënave Personale', të ndryshuar neni 6 "Kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave, pika 1/a, në të cilën percaktohet që: Të dhënat personale përpunohen vetëm: a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin, ZVAP Shkodër me shkresën nr. 120/1, datë 02.02.2021 i ka vënë në dispozicion renditjen e kandidatëve që kanë aplikuar për lëvizje paralele për vitin 2020-2021 në profilin edukim fizik, renditje e shpallur edhe në faqen zyrtare të ZVAP Shkodër...*

*Duke qenë se është krijuar një vend i lirë i profilit edukim fizik në shkollën 'Oso Kuka' për shkak të daljes në pension të mësueses së kësaj shkolle, aplikanti mësues F.B. me diplomë edukim fizik dhe sporte, me kualifikim të tretë, e cila ka marrë titullin mësues i kualifikuar, renditur e pari në profilin edukim fizik ka bërë lëvizjen paralele nga institucionin arsimor 'Branko Kadia' në institucionin arsimor 'Oso Kuka', pra mësues i sistemit arsimor..."*

2. Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së I. G., Komisioneri me shkresën Nr. 356/4 prot., datë 30.04.2021, njoftoi zhvillimin e seancës dëgjimore në datë 12.05.2021 duke kërkuar shpjegime shtesë.

Seanca u zhvillua në datën 12.05.2021, me praninë e palëve: përfaqësuesve<sup>6</sup> të DRAP Lezhë dhe ZVAP Shkodër, si dhe ankuesi I. G.

---

<sup>6</sup> Shtetësja N. M., me detyrë Juriste e DRAP Lezhë, me autorizim Nr. 631, datë 11.05.2021.  
Shtetësja M. T., me detyrë Juriste e ZVAP Shkodër, me autorizim Nr. 959, datë 10.05.2021.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, u njoftuan palët se seanca dëgjimore do të mbahej në procesverbal dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, palët i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Në vijim të seancës dëgjimore ankuesi parashtroi edhe një herë pretendimet e tij lidhur me diskriminimin e pretenduar nga ana e ZVAP Shkodër dhe DRAP Lezhë. Sa i përket shkakut të bindjeve politike, ankuesi sqaroi se nuk ka patur një aktivitet të njohur dhe publik në subjektin politik Partia Demokratike e Shqipërisë në të cilin bën pjesë, por ka qenë i angazhuar në strukturat e tij. Ndërkaq, sa i përket pretendimit për trajtim të diferencuar sqaroi ndër të tjera se është vënë në dijeni për një pozicion të lirë pune në profilin Edukim Fizik, në Shkollën “Oso Kuka”, në të cilin me anë të lëvizjes paralele ishte emëruar një mësuese e transferuar nga Shkolla “Branko Kadia”. Në këtë kuptim, kishte kërkuar të emërohej në këtë pozicion të lirë pune, por nga ana e drejtorisë së kësaj shkolle nuk ishte hapur vendi vakant. Për këtë, i është drejtuar me ankesë portalit “Mësues për Shqipërinë” dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Pas një inspektimi të kryer nga ana e strukturave përkatëse të DRAP Lezhë, është vënë në dijeni të një relacioni, në të cilin konstatohej se:

- Shkolla “Branko Kadia”, kishte 16 orë të lira në profilin Edukim Fizik dhe nuk i kishte shpallur;
- Shkolla “Salo Halili”, kishte 14 orë të lira në profilin Edukim Fizik dhe nuk i kishte shpallur;
- Shkolla “Ndre Mjeda”, kishte 5 orë të lira në profilin Edukim Fizik dhe nuk i kishte shpallur, duke ja shpërndarë këtë ngarkesë mësuesve të sistemit;

Megjithatë, ankuesi sqaroi se nga informacioni që disponon, në shkollat e ZVAP-së Shkodër nuk është emëruar ndonjë mësues i profilit Edukim Fizik, që ndodhet në renditje pas tij në portal apo jashtë sistemit. Aktualisht, ankuesi theksoi se është i punësuar me kontratë me afat në Shkollën “Qazim Mehja”, në profilin Edukim Fizik për 18 orë pune.

Gjithashtu, në përfundim sqaroi se nga ana e ZVAP Shkodër nuk i jepet mundësia për tu punësuar me kontratë pa afat, edhe pse ai mund të plotësohet me normë të plotë mësimore të shpërndarë në më shumë se një shkollë. Sipas tij ka raste, kur në faqen elektronike zyrtare të DRAP Lezhë, janë publikuar pozicione të lira, të cilat plotësohen me ngarkesë të plotë duke dhënë mësim në më shumë se një shkollë.

Nga ZVAP Shkodër, në vijim u sqarua se punësimi i mësuesve në institucionet që kjo zyrë arsimore mbulon, nuk ishte udhëhequr nga bindjet politike të kandidatëve për mësues. Për të punësuar një mësues, përfaqësuesja e ZVAP Shkodër sqaroi se: *“ZVAP në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës në të cilën ka një vend vakant apo ka orë të lira, bëjnë publik në faqen elektronike zyrtare pozicionin e lirë të punës, së bashku me orët përkatëse. Për vitin shkollor*

2020-2021, për shkak të rënies së numrit të nxënësve, është bërë një analizë e ngarkesës mësimore për mësuesit definitiv dhe ka rezultuar se në çdo profil kemi mësues tepër, pasi nuk plotësohen me ngarkesë të plotë mësimore. Bazuar në legjislacionin në fuqi, emërimi i një mësuesi bëhet nga drejtori i shkollës në të cilën ka orë të lira apo pozicion pune të lirë. Nuk ka kompetencë as ZVAP, as DRAP dhe as DPAP, të bëj emërimin e mësuesve në një shkollë. ZVAP bën monitorimin e ngarkesës mësimore dhe shpërndarjes së saj nga ana e shkollave.

Në rastin e I. G., atij i janë ofruar nga ana e ZVAP-së Shkodër vende të lira pune me kontratë provizore, por janë refuzuar prej tij. Gjithashtu, duke qenë se nga ana e ZVAP Kukës është paraqitur një pozicion i lirë për mësues të Edukimit Fizik me kontratë pa afat, i është ofruar edhe I. G., por nuk është pranuar prej tij. Aktualisht ankuesi është i punësuar në shkollën 'Qazim Mehja', me ngarkesë mësimore 18 orë.

Lidhur me shkollën 'Branko Kadia', është e vërtetë që mësuesja e sistemit ka bërë lëvizje paralele dhe ka shkuar në shkollën 'Oso Kuka', por për shkak të pandemisë në këtë shkollë nuk ka orë të lira të profilit Edukim Fizik, pasi janë shkurtuar orët nga 45 minuta në 30 minuta. Në rast se do të dalim nga skenarët e zhvillimit të mësimin si pasojë e situatës së pandemisë, atëherë në shkollën 'Branko Kadia', do të ketë 16 orë të lira. Pra, aktualisht në këtë shkollë nuk ka orë të lira të profilit Edukim Fizik.

Për të punësuar një mësues me kontratë pa afat, nevojitet që ai të plotësohet me normë të plotë mësimore, 22 orë, të shpërndara në një ose më shumë shkolla, por këto orë të mos rrezikojnë që në vitin e ardhshëm shkollor të reduktohen. Ndërsa, profili i Edukimit Fizik, nuk ka orë të lira në ZVAP Shkodër. Edhe nëse një kandidat plotësohet me normë të plotë për këtë vit shkollor, rrezikon që në vitin pasardhës të mbetet sërish pa ngarkesë, pasi në shkollat e ZVAP Shkodër nga viti shkollor 2016-2017 deri në vitin 2020-2021, ka një rënie të theksuar të numrit të nxënësve prej rreth 1800. Vetëm duke krahasuar vitin shkollor 2019-2020 me 2020-2021, ka një rënie të numrit të nxënësve me rreth 800 nxënës.

Në profile të tjera si: Muzikë apo Art Pamor, kemi mungesë të mësuesve dhe janë shpallur vende të lira me kontratë pa afat. Pra në rastin e ankuesit, pavarësiht nëse mund t'i plotësohet ngarkesa mësimore e plotë, nuk mund ta punësojmë me kontratë pa afat në kushtet në të cilat ndodhemi.”

Nga DRAP Lezhë, u sqarua ndër të tjera se: “Bazuar në ankesat e I. G. dhe të disa kandidatëve të tjerë, Drap Lezhë ka ngritur një grup pune për të analizuar ngarkesat mësimore të Edukimit Fizik në shkollat e ZVAP-së Shkodër. Është verifikuar ngarkesa mësimore në disa shkolla dhe është dalë me një relacion, ku është konstatuar se në shkollën 'Branko Kadia', si me pandemi dhe pa pandemi janë 16 orë të lira pune, në profilin e Edukimit Fizik, ndryshe nga çfarë pretendon ZVAP Shkodër dhe drejtoresha e kësaj shkolle. Pas konstatimeve të bëra, DRAP Lezhë ka dërguar për zbatim pranë ZVAP-së Shkodër gjetjet e grupit të inspektimit. Nga Drap Lezhë është rekomanduar shpallja e orëve të lira në shkollën 'Branko Kadia', por nuk janë



*shpallur nga ana e ZVAP-së dhe drejtueses së kësaj shkolle. Arsyetimi sipas drejtoreshës së shkollës 'Branko Kadia', sa i përket mos shpalljes së orëve të Edukimit Fizik, kishte të bënte me faktin se duhen mbrojtur mësuesit e sistemit dhe kjo ngarkesë i duhej shpërndarë atyre. Gjithashtu, kishte kërkuar në ZVAP Shkodër, të mos shpallen këto orë të lira. Pra, sipas nesh ka një paqartësi nga ana e drejtueses së shkollës në zbatimin e skenarëve të pandemisë dhe zbatimit të udhëzimeve sa i përket shpërndarjes së ngarkesës mësimore.*

*DRAP Lezhë ka nën juridiksionin e saj 10 ZVAP, të cilat janë: Shkodra, Lezha, Vau i Dejës, Malësia e Madhe, Kurbini, Kukësi, Mirdita, Hasi, Fushë Arrëz dhe Tropojë. Kandidatët që konkurojnë në portalin 'Mësues për Shqipërinë', marrin pjesë dhe zgjedhin 3 ZVAP për të konkuruar. Për të gjitha vendet e lira që hapen në këto 3 ZVAP, kandidati i renditur i pari në portal njoftohet për këtë vend. Në rast se, kandidati i renditur i pari nuk pranon të emërohet në këtë pozicion pune ose nuk kthen përgjigje brenda një afati prej 24 orësh, atëherë sipas renditjes njoftohen me rradhë kandidatët e tjerë pas tij, deri në momentin që të ezaurohet e gjithë lista e kandidatëve. Ndërkaq, nëse një ZVAP bën publik një pozicion pune dhe nuk gjen kandidat për këtë pozicion, atëherë njofton DRAP-in, i cili më pas ua përcjellë të gjithë ZVAP-ve të tjera që ka nën juridiksion, nëse ka ndonjë kandidat që do të pranojë emërimin në këtë pozicion të lirë pune. E njëjta situatë është paraqitur edhe për ankuesin në momentin që i është ofruar pozicionin i lirë me kontratë pa afat në një nga shkollat e ZVAP Kukës, në profilin Edukim Fizik.”*

Në përfundim të seancës, ankuesi theksoi faktin se do të pranonte një pozicion të lirë pune në profilin Edukim Fizik, brenda shkollave që ka nën juridiksion ZVAP Shkodër.

- 3.** Në kuadër të shqyrtimit të ankesës I. G., nëpërmjet e-mailit datë 09.06.2021, vuri në dispozicion të Komisionerit, informacionin e përcjellë atij nga ana e Platformës së Zyrës së Bashkëqeverisjes.

Në përgjigje të pretendimeve të tij, Zyra e Bashkëqeverisjes, ka sqaruar ndër të tjera se: “...Në vijimësi të komunikimit me ju, bëjmë me dije se nisur nga problematikat e krijuara në ZVAP Shkodër, aktualisht nga DPAP-ja ka nisur procedura disiplinore ndaj drejtuesit të zyrës Znj. Blediane Nika. Komisioni AD-HOC i ngritur me Urdhërin nr. 80, datë 25.05.2021 është mbledhur në datë 02.06.2021 dhe në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 99, datë 27.2.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, të Urdhërit Nr. 454, datë 13.09.2019 “Për miratimin e Rregullore dhe procedurat e konkurrimit për pranimin dhe lirimimin nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj”, mbështetur në nenin 14, Kreu 3, të Urdhërit Nr. 454, datë 13.09.2019, Komisioni Ad-Hoc ka relatuar dhe ka dëgjuar pretendimet e B. N.. Vendimi përfundimtar i parashikuar në rregullore; ‘Largim nga detyra apo vërejtje’, do të merret në datën 04.06.2021 në mbjedhjen e dytë të komisionit pasi sot ka pasur provim MSH dhe anëtarët e komisionit kanë qenë të angazhuar me këtë proces. Më tej brenda dy ditësh nga marrja e vendimit Drejtori i Përgjithshëm do të marrë në konsideratë dhe do të vendosë në lidhje me rekomandimin e komisionit Ad-Hoc. Sa i takon çështjeve për rastet e Edukimit Fizik, DPAP ka

*marrë në shqyrtim situatën duke analizuar ngarkesat mësimore për çdo mësues në shkollat e ZVAP Shkodër dhe do të dalë me një përfundim të qartë... ”*

4. Referuar e-mailit të sipërcituar, Komisioneri me anë të shkresës Nr. 365/5 prot., datë 17.06.2021, kërkoi nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP), DRAP-it Lezhë dhe ZVAP-së Shkodër, informacion<sup>7</sup> sa i përket pretendimeve të subjektit ankues.

Në përgjigje përsa më sipër, DPAP me shkresën<sup>8</sup> Nr. 1089/1 prot., datë 25.06.2021, sqaroi ndër të tjera se: *“...punësimi i mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë kryhet sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 13, datë 22.05.2019 ‘Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’, i ndryshuar. Procedurat punësimit udhëhiqen nga parimet e ligjshmërisë, të përgjegjshmërisë, si dhe nga vlerat e profesionalizmit, transparencës, meritës, të drejtës për zgjedhjen e institucionit arsimor, barazisë dhe interesit më të lartë të nxënësve, të përcaktuara në ligjin 69/2012 ‘Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar.*

*Ngarkesa mësimore e mësuesve në institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar përcaktohet në Udhëzimin nr. 30, datë 19.08.2018 ‘Për numrin e nxënësve për klasë dhe format e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar’.*

*Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Per Mbrojtjen nga Diskriminimi’, i ndryshuar, ju bëjmë me dije se nga informacioni i kërkuar nga Zyra Vendore Arsimore Shkodër nuk kemi konstatuar rrethana të ngjashme ose të njejta për persona të tjerë të cilët janë punësuar në institucionet arsimore në varesi të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, Shkodër si mësues të edukimit fizik përpara I. G. dhe kjo e drejtë t’i jetë mohuar vetëm I. G. apo të jetë përjashtuar qëllimisht duke e ekspozuar ndaj diskriminimit.*

*Referuar nenit 12/1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’, i ndryshuar, ju bëjmë me dije se udhëzimi i MASR, nr. 13, datë 22.05.2019 ka përcaktuar se vendet vakante shpallen në momentin kur ekziston ngarkesa e plotë mësimore në profil dhe çdo*

---

<sup>7</sup> Argumentimin, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

- Informacion dhe kopje të relacionit të Shkollës “Branko Kadia” Shkodër, lidhur me orët e edukimit fizik të cituar gjatë seancës dëgjimore nga ana e palëve në proces.
- Informacion dhe kopje të relacionit të DRAP Lezhë sa i përket inspektimit të kryer në shkollat e ZVA Shkodër, lidhur me orët e edukimit fizik.
- Kopje të korrespondencës së mbajtur ndërmjet DPAP-së, DRAP Lezhë dhe ZVA-së Shkodër, sa i përket zbatimit të relacionit dhe gjetjeve të DRAP Lezhë.
- Informacion (kopje të aktit) lidhur me vendimmarrjen e Komisionit Ad-Hoc, pas ankesave të ngritura nga subjekti ankues ndaj drejtuesëve të ZVA Shkodër.
- Informacion (kopje të aktit) nga ana e DPAP dhe DRAP Lezhë, nëse është marrë ndonjë masë ndaj strukturave të tjera të ZVA Shkodër sa i përket shpërndarjes së orëve të edukimit fizik në shkollat që mbulon kjo ZVA.

<sup>8</sup> Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 995 prot., datë 30.06.2021

pozicion tjetër pune me ngarkesë jo të plotë duhet shpallur si vend pune me kontratë pune me afat të përcaktuar.

Në Udhëzimin e MASR nr.13, datë 22.05.2019 janë përcaktuar edhe procedurat e rekrutimit dhe përzgjedhjes së punëmarrësve/punonjësve mësimorë në sistemin arsimor parauniversitar dhe në asnjë rast nuk përzgjidhet mësuesi sipas dëshirës së punonjësve të zyrës, por në varësi të renditjes në portal, mësuesi ka mundësi të përzgjedhë midis vendeve të punës që i ofrohen, me të drejtën e refuzimit deri në pozicionin që preferon.

Gjithashtu sqarojmë se në shkollën 9- vjeçare “Branko Kadia”, Shkodër për vitin shkollor 2020-2021 sipas informacionit të marrë nga Zyra Vendore Arsimore ishin 77 orë në profilin edukim fizik, të ndara në 14 orë në arsimin fillor dhe 63 orë në arsimin e mesëm të ulët (djem dhe vajza). Duke qenë se në shkollën 9- vjeçare “Branko Kadia” japin mësim në lëndën e edukimit fizik 3 mësues, pas plotësimit të tyre me ngarkesë mësimore (22 orë) ngelen vetëm 11 orë të lira në këtë profil. Këto orë në profilin edukim - fizik nuk përbëjnë një ngarkesë të plotë mësimore, por mund dhe duhet të propozoheshin si vend pune me orë/me kontratë pune me afat, mësuesit të renditur i pari në portalin ‘Mësues për Shqipërinë’.

Ka pasur vend që Zyra Vendore Arsimore Shkodër të bënte analizë të plotë të orëve të edukimit fizik edhe në shkolla të tjera.

Për kërkesat e tjera të renditura në shkresë ju bëjmë me dije se Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar në rekomandimet e raportit të monitorimit të kryer në ZVAP Shkodër me nr.2265/1 prot., datë 11.09.2020, ka kërkuar masa disiplinore për të gjithë personat përgjegjës që rezultojnë se me veprimet apo mosveprimet e tyre kanë shkelur legjislacionin në fushën e arsimit parauniversitar.

Në raportin e monitorimit të sipërcituar apo në vijim të trajtimit të rasteve të ndryshme të ankesave nga mësues të lëndëve të tjera si Arsim Fillor, Matematikë, Arte, etj. kemi konstatuar paaftësi dhe një analizë të cekët të Zyrës Vendore Arsimore Shkodër dhe për këtë qëllim DPAP ka nisur ecurinë disiplinore ndaj B. N. për të cilën tashmë kemi një vendim konkret të cilin po e përcjellim bashkëlidhur, ndërkohë jemi në proces të shqyrtimit në tërësi të shkeljeve të kryera gjatë ushtrimit të detyrës në këtë Zyrë Vendore Arsimore edhe nga punonjës të tjerë.

Gjithsesi, përtej gjithë analizës që po i bëhet punës në këtë Zyrë Vendore Arsimore nga DRAP apo DPAP, masave të marra ndaj ish drejtueses B. N. apo dhe proceseve në vijim ndaj punonjësve të tjerë, dalim në konkluzionin se pretendimet e I. G. për diskriminim për shkak të bindjeve politike janë të pabaza. Në asnjë rast nuk kemi konstatuar apo të kemi të dokumentuar zyrtarisht nga I. G. se është penguar të punësohet si mësues për shkak të bindjeve politike edhe në asnjë rast bindjet politike nuk kanë shërbyer si arsye për t’u punësuar si mësues në sistemin arsimor parauniversitar...”

ZVAP, në përgjigje të shkresës së sipërcituar, me shkresën<sup>9</sup> nr. 1393/1 prot., datë 01.07.2021, përcolli pranë Komisionerit, kopje të shkresave:

---

<sup>9</sup> Protokolluar pranë KMD-së me nr. 995/1 prot., datë 05.07.2021

- Nr. 183 prot., datë 10.12.2020 me lëndë “Informacion mbi ngarkesën mësimore të mësuesve të profilit edukim fizik në shkollën 9-vjeçare ‘Branko Kadia’”;
- Nr. 158 prot., datë 24.11.2020, me lëndë “Sqarim për orët e edukimit fizik”;
- Nr. 226 prot., datë 22.01.2021, me lëndë “Kthim përgjigje relacionit të shkollës ‘Branko Kadia’”;
- Nr. 229 prot., datë 25.01.2021, me lëndë “Informacion mbi numrin e klasave, numrin e orëve dhe mësuesit e edukimit fizik në shkollën 9 vjeçare ‘Branko Kadia’”;
- Nr. 2177/1 prot., datë 27.11.2020 DRAP Lezhë me lëndë “Për propozim për dhënien e masës disiplinore për B. N., Drejtor i Zyrës të Arsimit Parauniversitar Shkodër”.

5. Në kuadër të shqyrtimit të ankesës I. G., nëpërmjet e-mailit datë 06.07.2021, vuri në dispozicion të Komisionerit, informacionin duke sqaruar ndër të tjera se: “Kthim përgjigje e DPAP është e pabazë pasi vetë kjo drejtori më ka nisur një raport më datë 3.12.2020, që në shkollën Branko Kadia ka 16 orë të lira në edukimin fizik (po ju bashkangjis raportin).

Gjithashtu, tregon që ka pasur vend që Zyra Vendore Arsimore Shkodër të bënte analizë të plotë të orëve të edukimit fizik edhe në shkolla të tjera. Kjo tregon qartë që ZVAP Shkodër ka fshehur vendet dhe orët. Në asnjë pikë udhëzimi 13, datë 22.05.2019 nuk shpreh që norma mesimore për emërim duhet të jetë në një shkollë dhe nga takimi që unë kam pasur në Ministrinë e Arsimit me z. A. K., i cili është sekretar i përgjithshëm më ka cituar që emërimi mund të bëhet në dy ose më shumë shkolla, por duhet plotësuar norma 22 orë.

E vërteta është që DPAP nuk ka ardhur në Shkodër për këtë rast apo për inspektim, por ka kërkuar informacion nga ZVAP Shkodër ku ata si gjithmonë justifikonin shkeljet e tyre me relacione të pasakta .

Kthim përgjigje e ZVAP Shkodër është formuluar nga Znj. M., juriste e ZVAP Shkodër e cila dha dorëheqjen një ditë përpara se të merrej vendimi në ministri për shkarkimin e saj , pasi ishte e thirrur në komisionin e disiplinës për shkelje të rënda detyre .

Në këtë kthim përgjigje vura re dhe përgjigjet e drejtoreshës së shkollës Branko Kadia, Znj. S. M., e cila ka shkelur ligjin që në shtator të vitit 2021 për mosdeklarimin e orëve të edukimit fizik.

Unë isha vetë prezent në Janar të këtij viti ku S. M. është thirrur në DRAP Lezhë dhe deklarata e saj ishte që nuk mund të hap vendin pasi nuk më lejon ZVAP Shkodër. Po ju dërgoj përseri relacionet e inspektimeve, që tregojnë: 16 orë ka Branko Kadia, 14 orë Salo Halili, 5 orë shkolla Ndre Mjeda dhe 18 orë shkolla Qazim Mehja. Vetëm me këto orë unë duhet të isha emëruar pasi ka dhe plotë të tjera që nuk janë inspektuar. Gjithashtu, 2 muaj para se të mbyllet shkolla ka ikur një mësues i edukimit fizik, ku ka punuar B. V. dhe përsëri nuk është shpallur vendi vakant...”

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje objekt i ankesës dhe që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.**

Ligji Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

LMD<sup>10</sup> në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“2. Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij.”.*

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

I. G. ka qenë kandidat i portalit “Mësues për Shqipërinë”, për vitin 2020, në profilin Edukim Fizik dhe është renditur në vend të parë të klasifikimit. Në vijim, ka kërkuar punësimin e tij si mësues i Edukimit Fizik në institucionet arsimore në juridiksionin të ZVAP Shkodër.

Procedurat e punësimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar kryhen bazuar në dispozitat e Udhëzimit të MASR nr. 13, datë 22.05.2019 *“Për procedurat e emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’”,* të ndryshuar. Në pikën 10, Kreu I i këtij Udhëzimi, parashikohet se: *“DRAP dhe institucionet e varësisë kanë detyrimin të bëjnë publike vendet e lira të punës, në portalin “Mësues për Shqipërinë”, në faqen zyrtare të tyre dhe në stendat e informimit publik.”.*

---

<sup>10</sup> Shkurtesë e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar.

Referuar informacionit dhe provave të administruara, ankuesi është vënë në dijeni se në shkollën 9-vjeçare “*Branko Kadia*”, Shkodër, ishte larguar me lëvizje paralele një mësuese e profilit edukim fizik dhe në këto kushte i është drejtuar portalit “*Mësues për Shqipërinë*”, për të parë nëse është publikuar vendi i lirë i punës, pas largimit të mësueses së sipërcituar nga kjo shkollë. Duke qenë se ka vënë re që nga ana e ZVAP Shkodër dhe DRAP Lezhë nuk është bërë publikimi i vendit të lirë të punës, është drejtuar me një ankesë në portalin “*Mësues për Shqipërinë*” dhe Platformën e Bashkëqeverisjes, duke pretenduar se drejtoritë e institucioneve arsimore nuk bëjnë publike vendet e lira të punës.

Në momentin që DPAP dhe DRAP Lezhë janë vënë në dijeni të ankesës së I. G., drejtuar në portalet e sipërcituara, me Urdhrin Nr. 103, datë 16.11.2020 të drejtorit të DRAP Lezhë, është ngritur një grup inspektimi, për të kryer verifikimin e pretendimeve të ankuesit. Në vijim, DRAP Lezhë ka kërkuar nga ZVAP Shkodër dokumentacionin lidhur me Lëvizjen Paralele, vendet e lira të punës dhe ngarkesat mësimore të mësuesve të edukimit fizik për çdo institucion arsimor nën juridiksionin e ZVAP Shkodër. Nga informacioni i përcjellë nga ZVAP Shkodër, institucionet në juridiksionin e saj nuk kanë reflektuar orë të lira në profilin e edukimit fizik.

Nga informacioni që grupi i inspektimit të DRAP Lezhë ka administruar, pasqyruar në Relacionin datë 27.11.2020, ka rezultuar se:

- Për vitin shkollor 2020-2021, lëvizja paralele në ZVAP Shkodër është zhvilluar më datë 11.08.2020. Një kandidat i profilit edukim fizik ka kryer lëvizje paralele me dëshirë konkretisht F. B., mësuese e shkollës 9-vjeçare “*Branko Kadia*”, e cila është emëruar në gjimnazim “*Oso Kuka*”.
- Në shkollën “*Branko Kadia*”, ishin 16 orë të lira të profilit edukim fizik.

Përsa më sipër, DRAP Lezhë, në përfundim të inspektimit të zhvilluar, ka rekomanduar që:

- Shkolla “*Branko Kadia*”, bazuar në Udhëzimin nr. 13, datë 22.05.2019 “*Për procedurat e emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’*”, të dërgojë në ZVAP Shkodër, njoftim për shpalljen e 16 orëve të lira të lëndës edukim fizik.
- Shkolla “*Branko Kadia*”, të rishikojë shpërndarjen e ngarkesës mësimore të mësuesve sipas Udhëzimit nr. 30, datë 12.09.2018 “*Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar*”.

Në vijim, DRAP Lezhë ka dërguar pranë DPAP-së dhe ZVAP-së Shkodër, relacionin nr. 2177/1 prot., datë 27.11.2020, me konkluzionet e sipërcituara.

Ndërkaq, DRAP Lezhë, ka vijuar me inspektimin në disa shkolla të tjera nën juridiksionin e ZVAP Shkodër, ku ka konstatuar:

1. Në institucionin arsimor “*Salo Halili*”, dy mësuesit definitiv të profilit edukim fizik kanë përkatësisht 24 dhe 25 orë mësimore në javë secili, ose +2 dhe + 3 orë mbi normën e tyre. Pra, janë 5 orë të lira mësimore në profilin edukim fizik në shkollën “*Salo Halili*”.
2. Në institucionin arsimor “*Ndre Mjeda*”, 5 mësuesit definitiv të profilit edukim fizik kanë përkatësisht 22, 21, 24, 22, 22 orë mësimore. Si rezultat me 3 orët e profilit edukim fizik të shtuara në këtë situatë plotëson normën mësimore, mësuesi i profilit TIK megjithëse nuk janë profil i përafërt siç citohet në Udhëzimin Nr. 30, dt.12.08.2018, Kreu V- “*Të përgjithshme*”, pika 1.
3. Në institucionin arsimor “*Azem Hajdari*”, 2 mësuesit definitiv të profilit edukim fizik kanë përkatësisht nga 22 orë secili. Pra nuk ka orë të lira të profilit edukim fizik.
4. Institucioni arsimor “*Salo Halili*”, nuk kishte shpallur orët e lira sipas rekomandimit të DRAP Lezhë.

Përsa më sipër, DRAP Lezhë, në përfundim të inspektimit të zhvilluar, siç është pasqyruar edhe në relacionin datë 09.12.2020, ka rekomanduar që:

- Drejtoria e Shkollës “*Salo Halili*”, të rishikojë ngarkesën mësimore, duke u bazuar në Udhëzimin nr. 30, datë 12.09.2018 “*Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar*”, sipas shtojcës përkatëse të udhëzimit, pika 3, si dhe pika II/D Arsimit Bazë “*Norma mësimore javore e mësuesve dhe drejtuesve*”.
- Pas rishikimit të ngarkesës mësimore, në zbatim të Udhëzimit nr. 13, datë 22.05.2019 “*Për procedurat e emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’*”, drejtoria e institucionit arsimor “*Salo Halili*” në bashkëpunim me ZVAP Shkodër, të bëjnë shpalljen e orëve të edukimit fizik të pambuluara me mësues të profilit dhe ato mbi normë.

Me relacionin nr. 2282 prot., datë 09.12.2020, DRAP Lezhë ka dërguar në DPAP dhe ZVAP Shkodër gjetjet e grupit të inspektimit të sipërcituar.

Në nenin 60, të ligjit nr. 69/2012 “*Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar, parashikon se: “1. Në institucionin arsimor publik, përfshirë dhe atë parashkollor, pranimi dhe emërimi i mësuesit në një vend të lirë pune mbështetet në parimin e meritës dhe të drejtën për zgjedhjen e institucionit arsimor. Emërimi i mësuesit bëhet nga drejtori i institucionit arsimor, sipas renditjes në portalin “*Mësues për Shqipërinë*”. Procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune, si dhe administrimi i portalit “*Mësues për Shqipërinë*” përcaktohen me udhëzim të ministrit...”

Në zbatim të ligjit nr. 69/2012 “*Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar, është miratuar Udhëzimi i MASR-së nr. 13, date 22.05.2019 “*Për*

*procedurat e emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar, ku në Kreun kreu 1, pika 7 citohet se: “Vendet e lira të punës shpallen pasi është bërë plotësimi i kërkesave për lëvizje paralele dhe sistemimi i mësuesve që mbeten pa ngarkesë mësimore në zyrat vendore të arsimit parauniversitar (në vazhdim ZVAP) deri në 1 (një) ditë para fillimit të vitit mësimor.”*

Ndërsa në Kreun 4, pikat 4, 5, 7, 9 dhe 14 të Udhëzimit të sipërcituar, parashikohet se:

*“4. Për një vend të lirë pune, kandidati njoftohet nga ZVAP përmes postës elektronike, të cilën kandidati e ka deklaruar gjatë aplikimit online dhe me dosje.*

*5. Kandidati, i cili në renditjen e përgjithshme është renditur me numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën e zgjedhjes për vendin e lirë të punës dhe është i detyruar të konfirmojë në ZVAP brenda 24 orëve nëpërmjet adresës elektronike. Në rast të moskonfirmimit nga kandidati, ky pozicion pune i ofrohet kandidatit të listuar një rend më poshtë. Midis kandidatëve që rezultojnë me pikë të barabarta, përparësi ka kandidati që mund të jetë në kategorinë e personave me aftësi të kufizuara. Në rast se nuk ka persona me aftësi të kufizuara, vendi i lirë i punës i ofrohet kandidatit që ka rezultatin më të lartë në testim.*

*6. ...*

*7. Kandidati fitues paraqitet në institucionin arsimor ku ofrohet vendi i lirë i punës menjëherë sapo merr njoftimin. Ai i dorëzon drejtorit të institucionit dokumentin vërtetues, të printuar nga sistemi i aplikimit online, në portalin “Mësues për Shqipërinë.*

*8. ...*

*9. Kandidati punësohet nga drejtori i institucionit arsimor me kontratë pune individuale, me ose pa afat, sipas kërkesave të vendit të lirë të punës.*

*10. ...*

*11. ...*

*12. ...*

*13. ...*

*14. Në rast refuzimi të kandidatit fitues për vendin e lirë të propozuar, kandidati vazhdon të qëndrojë në renditje dhe atij i ofrohen vende pune të tjera të lira, deri në procedurat e hapjes së portalit të ri “Mësues për Shqipërinë”...”*

Nga provat e vëna në dispozicion nga palët në proces, rezultoi se ankuesit i janë ofruar nga institucionet arsimore dhe ZVAP Shkodër, pozicionet si më poshtë vijon:

1. Drejtorja e shkollës “Kolë Margjini” (shkolla Pyjore Shkodër) me e-mail të datës 17.11.2020, ka njoftuar që kandidatët I. G. dhe A. Sh., të cilët kanë refuzuar kërkesën për mësues të kësaj shkolle.
2. ZVAP Shkodër me datë 09.12.2020 ka bërë shpalljen për vend të lirë pune, me kontratë pa afat të caktuar, në profilin edukim fizik në shkollën “9- Shtatori”, Nj. Administrative



Topojan, Kukës, shpallje e dërguar nga DRAP Lezhë. I. G. ka refuzuar edhe këtë vend të lirë pune.

3. ZVAP Shkodër më datë 15.12.2020 ka bërë shpalljen për vend pune në shkollën “*Haxhi Hajdari*”, Nj. Administrative Rrethina, Shkodër. I. G. nuk ka kthyer përgjigje brenda 24 orëve siç parashikohet në kreun 4, pika 5 të Udhëzimit.

Në përfundim, ZVAP Shkodër më datë 26.02.2021, ka shpallur një vend të lirë punë me afat, profili edukim fizik, në Shkollën 9-vjeçare “*Qazim Mehja*”, i cili është pranuar nga ankuesi.

Pra, nga informacioni i sipërcituar, rezulton se ankuesit i janë ofruar vende të lira pune me afat nga ana e ZVAP Shkodër dhe institucionet arsimore nën juridiksionin e saj. Në momentin që ai ka rënë dakord me një nga pozicionet e ofruara më sipër, si në rastin e shkollës “*Qazim Mehja*”, ka pranuar pozicionin e punës dhe ka vijuar të zhvillojë mësimin në profilin e edikimit fizik pranë këtij institucioni arsimor.

Mbështetur në pretendimet e ankuesit gjatë seancës dëgjimore, ka pretenduar se ZVAP Shkodër, nuk i jep mundësinë për tu punësuar me kontratë pa afat, edhe pse ai mund të plotësohet me normë të plotë mësimore të shpërndarë në më shumë se një shkollë. Sipas tij ka raste, kur në faqen elektronike zyrtare të DRAP Lezhë, janë publikuar pozicione të lira, të cilat plotësohen me ngarkesë të plotë duke dhënë mësim në më shumë se një shkollë.

Udhëzimi Nr. 30, datë 12.09.2018 “*Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar*”, në pikën III/D, parashikon se normat mësimore javore e mësuesve dhe përcakton se: “...3. Mësuesi i gjuhës shqipe, i gjuhës së huaj, i matematikës, i fizikës, i biologjisë, i kimisë, i informatikës, i historisë, i gjeografisë, mësuesi në shkollat e arsimit special: 20 orë në javë. 4. Mësuesi i lëndëve të tjera: 22 orë në javë...”. Sipas këtij Udhëzimi e njëjta normë mësimore vlen për mësuesit e Arsimit Bazë dhe atij të Mesëm të Lartë/Gjimnazit.

Pra, referuar legjislacionit të sipërcituar dhe interpretimit të bërë nga ana e ZVAP Shkodër dhe DRAP Lezhë, për të punësuar një mësues me kontratë pa afat të caktuar, nevojitet që ai të plotësohet me normë të plotë mësimore, 22 orë, të shpërndara në një ose më shumë shkolla, por këto orë të mos rrezikojnë që në vitin e ardhshëm shkollor të reduktohen. Ndërsa sipas provave të vëna në dispozicion, profili i edukimit fizik, nuk ka patur orë të lira në ZVAP Shkodër, për punësimin e mësuesve me kontratë pa afat. Gjithashtu, referuar të dhënave të administruara nga ZVAP Shkodër, rezulton se nga viti shkollor 2016-2017 deri në vitin 2020-2021, ka një rënie të theksuar të numrit të nxënësve prej rreth 1800. Duke krahasuar vitin shkollor 2019-2020 me 2020-2021, ka një rënie të numrit të nxënësve me rreth 800 nxënës. Në këtë kuadër, rënia e

numrit të nxënësve nga viti në vit, potencialisht mund të sjellë për pasojë edhe reduktimin e orëve për profilin e edukimit fizik, si për të gjitha profilet e tjera.

Në përfundim, Komisioneri gjatë analizës së informacionit dhe provave të sipërcituara, konstatoi se:

- Pavarësisht faktit që nga ana e ZVAP Shkodër apo institucioneve arsimore nën juridiksionin e saj, nuk janë shpallur një pjesë e orëve të lira të profilit të edukimit fizik, nuk u konstatua që ky veprim apo mosveprim i tyre të jetë bërë me qëllim përjashtimin e ankuesit nga e drejta për tu punësuar;
- Nga ana tjetër, ZVAP Shkodër i ka ofruar disa mundësi punësimi ankuesit, të cilat i ka refuzuar, deri në momentin që është punësuar në një prej tyre me kontratë me afat të caktuar;
- Nuk rezultoi në asnjë rast, që të jetë punësuar një mësues tjetër i profilit të edukimit fizik me kontratë me afat të caktuar ose jo, përpara se t'i ofroheshin këto mundësi subjektit ankues;
- Nuk rezultoi se në ZVAP Shkodër apo DRAP Lezhë, të kishte pozicione të lira të profilit edukim fizik dhe të mos i ofroheshin subjektit ankues.

Përsa më sipër, pavarësisht nëse ZVAP Shkodër dhe institucionet arsimore nën juridiksionin e saj, mund të kenë kryer shkelje lidhur me moszbatimin korrekt të akteve nënligjore të sipërcituara, duke mos shpallur një pjesë të orëve lira të profilit të edukimit fizik, kjo situatë nuk ka vënë në pozita të pabarabarta apo të pafavorshme në raport me të tjerë.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si nga ligjet në fuqi.”

Në nenin 12/1/c) të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të

krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se DRAP Lezhë dhe ZVAP Shkodër, nuk kanë ndërmarrë veprime që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi të pabarabartë apo disfavorizues. Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se nuk kemi një trajtim të pabarabartë apo të pafavorshëm të subjektit ankues.

Në mungesë të një trajtimi të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e DRAP Lezhë dhe ZVAP Shkodër, për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, I. G., në të drejtën për punësim, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Shkodër, për shkakun e pretenduar prej tij.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Bindja politike)

(Fusha: Punësim)